



ti durrës

tregti - industri durrës

PERIODIK I DHOMES SE TREGTISE DHE INDUSTRISE DURRES Buletini 2/55 MARS 08

- SEKTORI I PESHKIMIT PREJ 9 MUAJSH NE PRAG FALEMENTIMI
- PERFAQESUESIT E DHOMES VIZITOJNE KOSOVEN
- REGJISTRIMI NE DHOME ME TEKNOLOGJINE BASHKOHORE TE INFORMACIONIT
- TAKIM PUNE I FORUMIT TE DHOMAVE TE TREGTISE TE HAPSIRES ADRIATIK-JON (Projekti ITAC)
- SEMINAR E-LARNING NE DHOME
- Dhoma organizon ne Durrës aktivitetin e perbashket me GLE
- SEMINAR NE DHOMEN E TREGTISE "RENDESIA DHE ZBATIMI I SISTEMIT HACCP NE INDUSTRIE USHQIMORE"
- MARVESHJA PER HEQJEN E TAKSIMIT TE DYFISHTE ME SLOVENINE
- PERFAQESUESIT E BIZNESIT TURISTIK NE DURRES MARRIN PJESE NE BURSEN NDERKOMBETARE TE TURIZMIT NE MILANO
- PËR TATIMIN E KALIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË SË PALUAJTSHME"
- C'PERFAQESON PER DURRESIN RRUGA DURRES - MORINE
- Panairë dhe misione tregtare
- Oferta nderkombetare

SEKTORI I PESHKIMIT PREJ 9 MUAJSH NE PRAG FALEMENTIMI

Reagojne Dhomat e
Tregtise te Tiranes,
Durrësit, Lezhës dhe Vlores



Peshkimi Durrës



Sipas nje VKM te veres 2005, anijet e peshkimit furnizoheshin nga ARMO me naftë 45 leke/liter, te cveshur nga te gjitha taksat, akcisa dhe TVSH. Por, qe prej 9 muajsh kjo skeme eshte nderprere, duke penguar e bllokuar zhvillimin e veprimtarise normale te sektorit te peshkimit ne te gjithe vendin.

Te shqetesuar per kete gjendje te renduar, Dhomat e Tregtise i jane drejtuar me nje leter Kryeministrit dhe ministrave te linjes, me ane te se ciles informojne dhe propozojne zgjidhje per situaten e krijuar.

Thelbi i propozimeve te kesaj letre permblihet si vijon:

Lëshimi i faturës tatimore me TVSH për peshkun e shitur.

Zbatimi i të njëjtës skemë, që përdoret në vendet e Bashkimit Europian, që garanton derdhjen e plate te TVSH per naften e furnizuar.

Furnizimi me naftë të jetë përgjegjësi individuale e çdo subjekti

Çmimi i naftës të jetë ai i magazinave doganore, pa akcizë dhe TVSH.

Kjo skeme ndryshon krejtësisht nga propozimi i fundit i Ministrise se Financave, sipas se ciles,